



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Seanca plenare e Kuvendit

SP-006

Prishtinë, më 25 dhe 26 tetor 2017

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 25 DHE 26 TETOR 2017**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti.

Kryesuesi i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2017.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Naser Rugova, Blerta Deliu-Kodra, Milaim Zeka, Korab Sejdiu, Glauk Konjufca, Islam Pacolli, Avdullah Hoti, Zafir Berisha, Fatmire Kollçaku, Vjosa Osmani, Danush Ademi, Veton Berisha dhe Albulena Balaj - Halimaj, si dhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Hykmete Bajrami i parashtroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me Buxhetin, numrin e stafit, kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Hykmete Bajrami i parashtroi pyetje ministrit të Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, në lidhje me kohën e planifikuar për ndryshimin e Ligjit për investimet strategjike.

Ministri Dardan Gashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me zbatimin e rezolutës së Kuvendit për organizimin e arsimit në Kosovë, si dhe ndarjen e Buxhetit për këtë çështje në vitin 2018, të jetë në përputhje me këtë rezolutë.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtroi pyetje kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me shkarkimet e tri bordeve të agjencive të pavarura.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me kyçjen e qytetit të Ferizajt në autostradën “Arbën Xhaferi”.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Haxhi Avdyli i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me mungesën e barnave për trajtimin e pacientëve me sëmundje të leukemisë.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Haxhi Avdyli i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria e Infrastrukturës për rregullimin e rrugës Prevallë - Zhupë - Brezovicë.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me hartimin dhe procedimin në Kuvend të Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip në Kosovë të viteve 1990 - 1999.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Lumir Abdixhiku i parashtroi pyetje kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me vendimin e Qeveria së Kosovës për faljen e borxheve të ambalazhuesve të ujit.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtroi pyetje kryeministrit Ramush Haradinaj në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për faljen e borxheve të ambalazhuesve të ujit.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me vështirësitë gjatë vendosjes së studentëve në konvikte në Qendrën Studentore në Prishtinë.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Arbër Rexhaj i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me përdorimin e plan-programeve mësimore të Serbisë në Kosovë, e sidomos në fshatrat e Gores në komunën e Dragashit.

Ministri Shyqiri Bytyqi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Drita Millaku i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria e Shëndetësisë për vdekjen e dyshimtë të tre pacientëve në QKUK, si pasojë e cilësisë së gazit oksidol.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Drita Millaku i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, në lidhje me qasjen në rrugën publike ose shpronësimin e 20 hektarëve tokë të pronave private në fshatin Vërmicë të Prizrenit.

Ministri Pal Lekaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 10 shtator dhe 2 tetor, si dhe seancave plenare të mbajtura më 3 dhe 4 tetor 2017.

4. Formimi i Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari të Komisionit të Pavarur të Mediave

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për ----- 72,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave, në këtë përbërje:

1. Shqipe Pantinanga GP i LVV-së, kryetare,
2. Nait Hasani nga GP i PDK-së, zv. kryetar i parë,
3. Jasmina Zhivković nga GP LS, zv. kryetare e dytë,
4. Adem Mikullović nga GP i LVV-së, anëtar,
5. Fisnik Ismajli nga GP i LVV-së, anëtar,
6. Lirije Kajtazi, nga GP i LDK-së, anëtare,

7. Imet Rrahmaninga GP i LDK-së, anëtar,
8. Xhevahire Izmaku nga GP i PDK-së, anëtare,
9. Rasim Selmanaj, nga GP i AAK-së, anëtar,
10. Milaim Zeka nga GP “Nisma për Kosovën”, anëtar dhe
11. Albert Kinolli nga GP “6+”, anëtar.

II. Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave duhet të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ai e ftoi ministrin e Financave që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi projektligjin e lartshënuar. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë në parim këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 diskutuan: në emër të Komisionit Funkcional, Lumir Abdixhiku; në emër të GP të LVV-së, Dardan Molliqaj; në emër të GP të LDK-së, Naser Osmani; në emër të GP të PDK-së, Safete Hadërgjonaj; në emër të GP të LS-së, Jelena Bontiq; në emër të GP të AAK-së, Blerim Kuçi; në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Enver Hoti; në emër të GP “6+”, Albert Kinolli dhe deputetët: Albin Kurti, Haxhi Avdyli, Flora Brovina, Teuta Haxhiu, Bilall Sherifi, Naser Rugova, Visar Ymeri, Xhevahire Izmaku, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Armend Zemaj, Mytaher Haskuka, Abdyl Salihu, Lumir Abdixhiku, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Zafir Berisha, Faton Topalli, Avdullah Hoti, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj, Albulena Balaj-Halimaj, Emilija Rexhepi, Besa Baftiu, Mërgim Lushtaku, Vjosa Osmani, Blerim Kuçi, Shqipe Pantina, Mimoza Kusari-Lila, Memli Krasniqi, Islam Pacolli, Arbërie Nagavci, Imet Rrahmani, Hajdar Beqa, Daut Haradinaj, Danush Ademi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Sala Berisha-Shala, Sami Kurteshi, Lutfi Zharku, Salih Salihu, Arbër Rexhaj, Kujtim Shala, Saranda Bogujevci, Arben Gashi, Rasim Selmanaj, Ganimete Musliu dhe Fitore Pacolli, si dhe ministrat Bedri Hamza, Pal Lekaj dhe Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund të diskutimeve, ministri i Financave, Bedri Hamza dha shpjegime për çështjet që ngritën deputetët gjatë diskutimeve në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të këtij projektligji. Nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje. Ai e përsëriti edhe një herë votimin, por edhe kësaj radhe vetëm 60 vota ishin “për”. Meqë nuk kishte kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje, Kryetari i ndërpreu punimet e seancës në orën 21:19 minuta, për të vazhduar të nesërmen, më 26 tetor 2017, në orën 10:00.

E enjte, më 26 tetor 2017, në orën 10:00

Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 25 tetor 2017

Kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

5. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar më 25 tetor 2017, por për mungesë të kuorumit për vendimmarrje, votimi i këtij projektligji është shtyrë për sot.

Kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të projektligjit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 61,
Kundër -----0,
Abstenime -----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.
2. Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Në vazhdim, kryetari i Grupi Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, i propozoi Kuvendit mocionin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e dytë të këtij projektligji.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me mocionin e parashtruar.

Lidhur me mocionin e lartshënuar, të parashtruar nga kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së diskutuan: Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Sasha Milosavleviq, në emër të GP të LS-së; Haxhi Shala, në emër të GP të “Nismës për Kosovën” dhe Albert Kinolli, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre deklarimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin për shmangie nga afatet procedurale për shqyrtimin e dytë të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	61,
Kundër -----	28,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 57, paragrafët, 3, 5, 8 dhe 9 dhe nenin 64, paragrafi 4, të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

1.1 Amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 mund t’i adresohen Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa deri më 27 tetor 2017.

1.2 Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa deri më 30 tetor 2017 duhet ta shqyrtojë projektligjin dhe raportin me rekomandime t’ua paraqesë komisioneve të përhershme.

1.3 Komisionet e përhershme deri më 30 tetor 2017 duhet ta shqyrtojnë projektligjin dhe raportet me rekomandime t’ia paraqesin Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.

1.4. Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa deri më 30 tetor 2017 duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

1.5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 bëhet në seancën plenare më 31 tetor 2017, në orën 10:00.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët e Kuvendit se Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryesuesi e ftoi Auditorin e Përgjithshëm që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor të auditimit për vitin 2016.

Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin vjetor të auditimit për vitin 2016. Diskutimi i tij është dhënë i plotë në transkript.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike deputeti Mërgim Lushtaku e paraqiti raportin me rekomandime të komisionit lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2016.

Në vazhdim, kryesuesi e hapi debatin për raportin vjetor të auditimit për vitin 2016.

Lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2016 diskutuan: Faton Topalli, në emër të GP të LVV-së; Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Mërgim Lushtaku, në emër të GP të PDK-së; Verica Çeraniq, në emër të GP të LS-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti në emër të GP të “Nismës për Kosovën”, si dhe deputetët: Shqipe Pantina, Hajdar Beqa, Teuta Haxhiu, Zafir Berisha, Fatmire Kollçaku, Besa Gaxherri, Milaim Zeka, Drita Millaku, Glauk Konjufca, Kujtim Shala, Sami Kurteshi, Arbër Rexhaj, Naser Rugova, Haxhi Shala, Fitore Pacolli, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Ismajl Kurteshi, Besa Baftiu dhe Arbërie Nagavci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të auditimit për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	72,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti vjetor i auditimit për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

7. Propozimi i grupeve parlamentare për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesuesi i njoftoi deputetët me propozimet e grupeve parlamentare të LVV-së dhe “6+” për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Ai kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozimet e grupeve parlamentare të LVV-së dhe “6+”.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M **Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 06-V-006**

I. Vendimi nr. 06-V-006, datë 3 tetor 2017, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

1. Deputeti Liburn Aliu nga Grupi Parlamentar i LVV-së emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.
2. Deputetja Fatmire Kollçaku nga Grupi Parlamentar i LVV-së emërohet anëtare në Komisionin për Integritet Evropian, në vend të deputetit Driton Çausi.
3. Deputeti Driton Çausi nga Grupi Parlamentar i LVV-së emërohet anëtar në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Ali Lajçi.
4. Deputeti Ali Lajçi nga Grupi Parlamentar i LVV-së emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.
5. Deputeti Fikrim Damka nga Grupi Parlamentar “6+” emërohet anëtar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetes Mufera Srbica-Shinik.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 13:32 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale